

STATUTI

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Titaniku 2020" Shpk

Ne kete statut :

- "Ligji" eshte Ligji 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare";
- "Statuti" eshte statuti i shoqerise;
- "Dite te Plota" ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk perfshin ditene kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimi dhe ditene per te cilen eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi.

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia dhe Kontakti

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me date 06.07.2020, themeluesi, harton Statutin e Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin "Titaniku 2020" Shpk ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

Themeluesi i shoqerise eshte :

► Shoqeria "CMR Holding" shpk e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 26.04.2013 me Nipt-in L31626501S dhe me seli ne Lagjen 14, Rruga ish Ndermarja e serave Shkozet Durres

Neni 2

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem : Import eksport. Dhenie me qera te objekteve; Tregeti me shumice dhe pakice te te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit; tregeti me shumice e pakice te artikuj industriale, ushqimore, bujqesore dhe blektorale; tregeti makineri e paisje, artikuj konsumi, hapje dyqane e lokale per restorante e bar bufe, hotelcri; transport tokesor dhe detar, mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit.

Neni 3

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete mbi 10 (dhjete) vjet

Neni 4

Selia

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen : Lagja 14, Rruga ish Ndermarja e serave, Pasuria 1/514/ND, Zona Kadastrale 8515, Shkozet Durres.

Kreu II

Organet Drejtuese dhe Kapitali i Regjistruar



Neni 5
Organet Drejtuese

Organet Drejtuese te shoqërisë tregtare "Titaniku 2020" shpk jane :
 ♦ Ortaku i Vetem dhe
 ♦ Administratori

Neni 6

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali themeltar i shoqërisë është kontribut ne natyre (Neni 10 pika 2 dhe Neni 68 pika 5, te ligjit 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare") ne vleren 96.562.575 leke lekë, perbehet nga 1 (nje) kuote dhe i formuar në masën 100 % nga kontributi i Ortakut Themelues "Titaniku 2020" Shpk.

Kontributi ne natyre, prona te patundeshme, te vendosura nga organi vendimarrës i Ortakut themelues per ti kaluar ne shoqerine "Titaniku 2020" shpk, konsiston ne:

Nr.	Çertifikata	Data	Zyra e regjistrimit	Zona Kadastrale Nr.	Numri Pasurisë	Vol um i	Faqe	Lloji i pasurisë	Siperfaqja	Vlera kontabël
1	2053438	11.03.2020	Durres	8515	1/819	38	45	Truall	829	14,346,300
2	2053440	11.03.2020	Durres	8515	1/820	38	46	Truall	1036	12,432,875
3	1731074	31.05.2018	Durres	8515	1/515-ND	26	29	ND (kapanon)	860.7	372,575
4	1983336	09.10.2019	Durres	8515	1/576	28	38	Truall	970	10,000,000
5	1622173	31.05.2018	Durres	8515	1/514-ND	26	28	ND (kapanon)	860.7	372,575
6	1983335	09.10.2019	Durres	8515	1/577	28	37	Truall	1067	16,000,000
7	1731075	31.05.2018	Durres	8515	1/538-ND	26	119	ND (kapanon)	640	277,040
8	1983346	09.10.2019	Durres	8515	1/593	28	50	Truall	695	14,000,000
9	1731076	31.05.2018	Durres	8515	1/539-ND	26	120	ND (kapanon)	765	331,150
10	1983348	09.10.2019	Durres	8515	1/594	28	51	Truall	830	16,000,000
11	1731077	31.05.2018	Durres	8515	1/540-ND	26	121	ND (kapanon)	993.5	430,060
12	1983347	09.10.2019	Durres	8515	1/595	28	52	Truall	1080	12,000,000
Shuma										96,562,575

Neni 7


Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Ortakut te Vetem.

Neni 8

Certifikatat e kuotave

Ortaku i Vetem ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letres me vlerë.



Neni 9

Kalimi me Kontratë i Kuotave

1. Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratori. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

2. Administratori mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratori nuk bie dakord me personin të cilit i kalon kuota.

3. Nëse Administratori refuzon të regjistrojnë kalimin e kuotës, ai do të njoftojë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

Neni 10

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

1. Nëse Ortaku i Vetem vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

2. Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër të caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

3. Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të Ortakut të Vetem do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

Neni 11

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

1. Ortaku i Vetem, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Ortaku i Vetem.

2. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Ortakut të Vetem.

Neni 12

Blerja e Kuotave të Veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen Ortakut të Vetem apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit.

Kreu III

Ortaku i Vetem

Neni 13

Ortaku i Vetem



Ortaku i Vetem nëpërmjet vendimeve që merr, realizon të gjithë veprimtarinë e shoqërisë. Ai përcakton drejtimit kryesore, vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut, për shtimin dhe zvogelimin e kapitalit, për pranimin në shoqëri të ortakëve të tjerë, të gjitha këto në zbatim të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 14

Thirrja e Ortakut të Vetem

1. Administratori thërret Ortakun e Vetem.

Kreu IV

Administratori

Neni 15

Emërimi i Administratorit

1. Ortaku i Vetem zgjedh një ose më disa persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë nga Ortaku i Vetem, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

2. Kufizimet në lidhje me emërimin e Administratorit parashikohen në pikën 2 të nenit 95 të Ligjit.

3. Administrator i shoqërisë caktohet Ahmet Bajrami

Neni 16

Kompetencat e Administratorit

1. Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratori, i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Ortakut të Vetem sipas nenit 81 të Ligjit. Ndryshimet e statutit nga Ortaku i Vetem dhe udhëzimet e Ortaku i Vetem nuk do të shfuqizojnë aktet e mëparshme të Administratorit, të cilat do të ishin të vlefshme nëse ndryshimi nuk do të ishte kryer ose udhëzimi nuk do të ishte dhënë.

2. Administratori mund t'ua delegojë kompetencat e tij çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendos Administratori dhe mund të revokohet ose ndryshohet.

3. Administratori lidh kontrata me persona fizikë e juridikë shtetërorë ose privat, vendas e të huaj sipas vendimeve që merr Ortaku i Vetem si dhe ndjek drejtimit e aktivitetit të shoqërisë. Administratori ka të drejtë të emërojë përfaqësues të posaçëm çdo person të tretë për të kryer veprime në emër të tij për llogari të shoqërisë.

Neni 17

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit


Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie pague;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë.

Neni 18

Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit

1. Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Ortaku i Vetem në përputhje me parashikimet e nenit 97 të Ligjit.



2.Ortaku i Vetem mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënie e përfitimeve të tilla.

3.Administratorit mund t'i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e Ortakut te Vetem në lidhje me përmbushjen e detyrave të tij.

Neni 19

Mbledhjet e Administratorit

1.Mbledhjet e Administratorit do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

2.Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e Administratorit, do të konsiderohen të vlefshme njëllë sikur ky person të ishte emëruar rregullisht dhe të ishte cilësuar e të vazhdonte detyrën si Administrator.

Neni 20

Kufizimet në Votimet e Administratorit

Administratori nuk do të lidhe marrëveshje për çështje në të cilat ky ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur Ortaku i Vetem, ka rënë dakord që:

1. të autorizojë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe

2. të autorizojë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 21

Procesverbalet Administratorit

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratori; dhe

2. të gjitha mbledhjeve të Ortakut te Vetem

Kreu V

Dividendët dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 22


Dividendët

1.Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Ortakut te Vetem mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

2.Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

3.Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

4.Cdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e



maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Ortaku i Vetem, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

Neni 23

Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Ortaku i Vetem, duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Kreu VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 24

Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Ortakut të Vetem, mund të shpërndajë në dobi të Ortakut të Vetem, të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri.

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet që ortaku merr përsipër si person fizik tej veprimtarisë së shoqërisë dhe nuk përballon personalisht humbjet e shoqërisë tej kontributit të kapitalit të vënë në shoqëri.

Neni 25

Njoftimet

1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

2. Shoqëria mund të njoftojë Ortakun e Vetem personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të Ortakut të Vetem ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga Ortaku i Vetem. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Kreu VII

Dispozita të Fundit dhe Kalimtare

Neni 26

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje "Titaniku 2020" Shpk Shpk, Durrës.

Neni 27

Shoqëria është e detyruar të mbajë dokumentacionin kontabël, librin e shoqërisë në të cilin shënohen emri i plotë i shoqërisë, Ortakut të Vetem, kapitalin themeltar si dhe vendimet që merr ortaku i vetem.

Bilanci financiar mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël miratohen nga Ortaku i Vetem. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar. Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë për çdo arsye. Për këtë Ortaku i

Vetem vendos për mënyrën e likujdimit të saj ku caktohen një ose disa likujditorë.

Neni 28

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likujdimit do të paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente.

Neni 29

Përsa nuk është parashikuar në këtë statut, i referohet ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 30


Ky statut është hartuar në 4 kopje për tu administruar sipas ligjit.

Ortaku i Vetem Themelues

Shoqëria "CMR Holding" Shpk

Perfaqesuesi Ligjor

Ahmet Bajrami

A large, stylized handwritten signature in black ink, which appears to read "Ahmet Bajrami", is written over the printed name. The signature is enclosed within a large, loopy oval shape.